



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance



Dogana e Kosovës - Carina Kosova - Kosovo Customs

05.2.1/807

B.P.

Dogana e Kosovës, duke vepruar sipas kërkesës së subjektit në procedurë “Ministria e Punëve të Brendshme” – Prishtinë, me numër fiskal 600132823, për rishqyrtimin e aktvendimit 04.3.2/861 të datës 13.12.2012, i lëshuar nga Sektori i Auditimit, në vështrim të nenit 291 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës (Nr.03/L-109) i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-099 si dhe konform nenit 136, pika (a), të Ligjit mbi Procedurën Administrative, sjell këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET kërkesa e subjektit në procedurë “Ministria e Punëve të Brendshme” – Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit 04.3.2/861 të datës 13.12.2012 i lëshuar nga Sektori i Auditimit, si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Sektori i Auditimit me aktvendimin e atakuar nr. 04.3.2/861 të datës 13.12.2012, ka obliguar subjektin në procedurë “Ministria e Punëve të Brendshme” – Prishtinë, që të paguaj shumën e përgjithshme të obligimeve prej 354,052.20€ në emër të borxhit doganor, për mallin lëndor të zhdoganuar me Deklaratat Unike Doganore si në aktvendimin e atakuar.

Sektori i Auditimit duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 82 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, bazuar në delegimin e kompetencës, sipas kërkesave nga Zyra Doganore Pejë dhe Zyra doganore Intereuropa për Auditimin e lëndëve të importuesit “Ministria e Punëve të Brendshme” me seli në Prishtinë për mallin “Pasaporta Elektronike (Biometrike)”, ka kryer procedurat e nevojshme për të audituar lëndët/deklaratat unike doganore: IM4 %13998/23.09.2011; %16403/28.10.2011; %16772/02.11.2011; %17883/22.11.2011 të Zyrës Doganore në Pejë.

Me datën 07.12.2012 Sektori i Auditimit të Jashtëm ka bërë një vizitë në Departamentin për prodhimin e dokumenteve në kuadër të MPB-së, ku nga përgjegjësit janë informuar se pasaportat janë importuar si dokumente të lidhura me kartelën e integruar, të zbrazët ku informatat

personale, fotografia dhe plotësimi i kartelës (çipit) ishin veprimet e vetme që ndërmerreshin nga ky Departament para se pasaportat të ishin të gatshme për shpërndarje. Po ashtu zyrtarë nga Sektori i tarifës që ishin prezent gjatë kësaj vizite, mblodhën informacione dhe prova konkrete të cilat edhe iu shërbyen si provë për përcaktimin e drejtë të kodit tarifor 4911 9900 00 si dhe për përcaktimin e përshkrimit të drejtë të mallit si Dokumente identifikuese – Pasaporta Biometrike. Andaj Sektori i Auditimit të Jashtëm në bazë të klasifikimit tarifor nr. 49-T/2012 i datës 04.12.2012 i lëshuar nga sektori i tarifës, konstaton se me rastin e deklaramentit dhe zhdoganimit mallit nga ana e subjektit në procedurë nuk është vepruar drejtë, me ç'rast edhe është konstatuar se malli lëndor kontestues duhet ti nënshtrohet pagesës së taksave importuese me shkallën prej 27.6%.

Provë: Aktvendimi i Sektorit të Auditimit nr. 04.3.2/861/13.12.2012 dhe mendimi mbi klasifikimin tarifor nr. 49-T/2012/04.12.2012.

Subjekti në procedurë “Ministria e Punëve të Brendshme ” – Prishtinë, brenda afatit ligjor me datë 26.12.2012 ka ushtruar ankesë për rishqyrtimin e aktvendimit të lëshuar nga Sektori i Auditimit. Subjekti në ankesën e atakon vendimin e Sektorit të Auditimit për shkak se MPB-ja me OESD-në ka lidhur kontratën nr. 2141009912 për furnizimin me Pasaporta Elektronike në të cilën kontratë janë përcaktuar shumë qartë të drejtat dhe obligimet e secilës palë. Subjekti në procedurë thekson se sipas kontratës MPB-ja është vetëm blerës e jo edhe importues i pasaportave elektronike, ashtu siç pretendon Dogana e Kosovës. Më tej subjekti në procedurë thekson se neni 3.1 i kontratës përcakton shumë qartë se kompania OESD është obliguar që të paguaj të gjitha taksat doganore, tatimet dhe TVSH-në duke marrë parasysh se në këtë paragraf është përcaktuar pariteti DDP sipas Incoterms 2000. Po ashtu subjekti thekson se neni 5 i pjesës së tretë të Kontratës ku janë paraparë kushtet e veçanta të kontratës, operatori ekonomik (OESD) ka qenë i obliguar të regjistrohet në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë të Kosovës, brenda një afati të arsyeshëm kohor pas dhënies së Kontratës, me qëllim të kryerjes së obligimeve doganore, tatimeve dhe TVSH-së, që rrjedhin nga kontrata. Andaj në bazë të dispozitave përkatëse të kontratës dhe dispozitave përkatëse të DDP-së, MPB-ja nuk është e obliguar t'i paguaj taksat doganore dhe TVSH-në, por këto obligime duhet të kryhen nga OESD-ja ose përfaqësuesi i autorizuar i OESD-së i regjistruar në Kosovë.

Lëndes i janë bashkangjitur: ankesa Nr. 05.2.1/807/26.12.2012, aktvendimi 04.3.2/861 të datës 13.12.2012 nga Sektori i Auditimit, Mendimi mbi klasifikimin tarifor nr. 49-T/2012 i datës 04.12.2012, shkresa e datës 10.12.2012, kontrata me numër 214 10 099 112 e nënshkruar me datë 17.06.2011, DUD-at nr. IM4 %13998/23.09.2011; %16403/28.10.2011; %16772/02.11.2011; %17883/22.11.2011 të Zyrës Doganore në Pejë, autorizimi i datës 26.03.2009, faturat e mallit lëndor kontestues.

Dogana e Kosovës pas pranimit të kërkesës së subjektit në procedure “Ministria e Punëve të Brendshme ” – Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit 04.3.2/861 të datës 13.12.2012 i lëshuar nga Sektori i Auditimit, aktvendim me të cilin është obliguar subjekti në procedurë që të paguaj obligimet për borxhin doganor në shumën e cekur në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke vlerësuar gjendjen faktike, shkresat e lëndës, shkaqet e aktvendimit të atakuar si dhe duke vlerësuar thëniet dhe pretendimet e subjektit në procedurë gjen se kërkesa e subjektit në procedurë është e pa bazë, për arsye se;

Dogana e Kosovës fillimisht konstaton se Sektori i Auditimit ka vepruar drejtë kur duke vepruar sipas detyrës zyrtare ne vështrim te nenit 82 pika 1 dhe 3 te Kodit Doganor dhe te Akcizave, ka ndërmarrë masat e nevojshme për rregullimin e situatës dhe kur ka obliguar subjektin në procedurë që të paguaj detyrimet doganore në shumën e cekur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Sektori i Auditimit deri të një konstatim i tillë ka ardhur duke marrë për bazë faktet e reja të cilat janë siguruar gjatë zhvillimit të procedurës së auditimit të deklarave importuese, si dhe pas vizitës së realizuar tek subjekti ankimor se bashku me Sektorin e Tarifës ku nga zyrtaret përkatës te Departamentit te Prodhimit te Dokumenteve ne kuadër te MPB-se, është konfirmuar se pasaportat e importuara janë “dokumente te lidhura me kartelën (çipin) e integruara te zbrazet”. Sektori i Tarifës duke u bazuar ne gjendjen faktike, përkatësisht faktin se dokumentet identifikuese janë te pajisura me karte te mençur (çipin), por i cili është i paplotësuar, bazuar ne rregullat gjenerale te klasifikimit te mallrave, konkretisht bazuar ne rregullën gjenerale 3 b, kane konstatuar se karakterin thelbësor ne këtë rast e jep dokumenti identifikues pasi qe çipi është blanko (i paplotësuar me te dhëna) dhe si i tille nuk mund te jap karakterin thelbësor te mallit lëndor, andaj klasifikimi i sakte është ne Kodin Tarifor **4911 9900 00**, dhe përshkrimi i duhur i mallit lëndor “**Dokumente Identifikuese – Pasaporta biometrike**”.

Provë: Mendimi Tarifor Nr. 49-T/2012 i dt. 03.12.2012 dhe Aneks mendimi mbi klasifikimin tarifor i dt. 04.12.2012.

Dogana e Kosovës me tutje thekson se Sektori i Auditimit duke u bazuar ne mendimi mbi klasifikimin tarifor te lartcekur, ka konstatuar se me rastin e deklarimit dhe zhdoganimit te mallit lëndor ne Z.D Pejë sipas DUD-ave të lartcekur, subjekti ankimor nuk e ka deklaruar saktë numrin tarifor, pasi që në bazë të mendimit për klasifikim tarifor të lëshuar nga Sektori i Tarifës është konstatuar se malli lëndor i nënshtrohet pagesës se tatimit doganor dhe TVSH-se, andaj edhe ka vepruar drejte kur subjektin ankimor e ka obliguar për pagesë të detyrimeve doganore në lartësi prej 354,052.20 €,

Dogana e Kosovës sa i përket pretendimit te subjektit ankimor se sipas kontratës MPB-ja është vetëm blerës e jo edhe importues i pasaportave elektronike, e cilat është e përcaktuar edhe me nenin 3.1 te kontratës, ne baze te cilës kompania OESD është obliguar që të paguaj të gjitha taksat doganore, tatimet dhe TVSH-në duke marrë parasysh se në këtë paragraf është përcaktuar DDP-ja sipas Incoterms 2000, thekson se ne shkresat e lendes ekziston autorizimi i MPB-se i lëshuar për agjentin doganor “Shala Trade”, në bazë të së cilit i njëjti është autorizuar që të bëjë zhdoganimin e mallrave që importon apo eksporton MPB-ja, fatura origjinale dhe dokumentet tjera po ashtu janë te lëshuara ne emër të MPB-se, andaj proceduralisht dhe ligjërisht fillimisht zyra doganore ka vepruar drejte kur i ka pranuar DUD-at në fjale ne vështrim te nenit 67 dhe 68 te KDA-se, dhe me pas edhe Sektori i Auditimit kur e ka obliguar subjektin ankimor për pagese te borxhit doganor, pasi qe në vështrim të nenit 198.3 te Kodit Doganor dhe te Akcizave parashihet se debitor është deklaruesi i mallit, dhe në këtë rast nuk është kontestuese se malli është deklaruar ne llogari dhe emër te MPB-se.

Neni 67 citat: “*Deklaratat që plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 66, do të pranohen menjëherë nga Dogana, me kusht që mallrave të cilave ajo u referohet të jenë paraqitur në doganë.*” dhe

Neni 68 citat: "1. Pa rënë ndesh me nenin 10, deklarata doganore mund të bëhet nga çdo person që është në gjendje të paraqet ose që bën të mundur paraqitjen e mallrave pranë Doganës, së bashku me të gjitha dokumentet e kërkuara për aplikimin e dispozitave mbi procedurën doganore për të cilën janë deklaruar mallrat."

Neni 198.3 citat: "Debitor është deklaruesi. Në rast të përfaqësimit të tërthortë, personi në llogari të të cilit bëhet deklarata doganore."

Provë: Autorizimi i MPB-se për agjentin doganor, faturat e mallit.

Dogana e Kosovës po ashtu e hedhe poshtë pretendimin e subjekti ankimor sa i përket paritetit DDP, pasi që ne fature të mallit dhe DUD-at kontestues figuron pariteti CIP Prishtina, që nënkupton se shpenzimet e transportit janë të përfshira në vlerën e mallit lëndor, dhe ky paritet nuk ndërlidhet me faktin se kush i bart obligimin për pagesë të detyrimeve doganore.

Po ashtu është evidente se MPB-ja edhe përkundër faktit se malli lëndor është zhdoganuar në muajt **Shator- Nëntor 2011** dhe i njëjti me gjithë dokumentacionin përcjellës është pranuar nga MPB-ja dhe deri sa është lëshuar aktvendimi nga ana e Doganës (**13.12.2012**), MPB-ja nuk i ka kundërshtuar fare DUD-at në kuptim të asaj që ajo nuk duhet të jetë deklarues i mallit por OESD-ja, dhe të kërkoj anulimin e deklaratave.

Dogana e Kosovës me tutje thekson se nuk e konteston mundësinë që MPB-ja t'i ketë rregulluar raportet e saj me OESD-në me ane të kontratës, mirëpo kjo paraqet marrëdhëniet të tyre Inter partes, dhe nuk ndërlidhet me aplikimin e procedurave dhe dispozitave doganore, pasi si edhe u cek më lartë në aspektin procedural dhe ligjor dokumentacioni përcjellës i mallit ka qenë i harmonizuar dhe i kompletuar për aplikim të procedurave doganore, ashtu edhe siç kërkohet në vështrim të nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009.

Në vështrim të asaj që u tha ma lartë Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë dhe duke u bazuar në provat e lartcekura, ka konstatuar se kërkesa e subjektit ankimor është e pa bazuar, andaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke e lënë në fuqi aktvendimin e lëshuar nga Sektori i Auditimit.

Pretendimet tjera nuk janë esenciale për të vendosur ndryshe nga ajo që u vendos në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Datë: 24 Janar 2013

Kopjet për :
1 për palën
1 për lëndë
1 për arhivë
1 për Sektorin e Auditimit

Sipas Autorizimit të Drejtorit Gjeneral

Nazmi BERISHA

